

VENDIM
Nr. 2, datë 5.2.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 2, DATË 15.2.2019, TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI, “PËR PROCEDURËN E SHORTIT TË CAKTIMIT TË RELATORËVE PËR POZICIONET VAKANTE NË ÇDO INSTITUCION”

Në mbështetje të pikave 2 dhe 3, të nenit 228, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Pas pikës 5, të vendimit nr. 2, datë 15.2.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Kur procedura e verifikimit dhe e vlerësimit të kandidatëve nuk ka përfunduar gjer më 31 dhjetor, atëherë dita dhe ora e zhvillimit të procedurës së shortit elektronik për caktimin e relatorit caktohet jo më vonë se 3 ditë nga dita e konstituimit të Këshillit të radhës. I njëjti afat zbatohet edhe kur procedohet me zëvendësimin e relatorit për shkak të ligjshëm gjatë veprimtarisë së të njëjtit Këshill”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ardian Dvorani